

LIGJ
Nr. 79/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2006, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 23, ndryshojnë si më poshtë:

“2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në llogarinë e tij elektronike në sistemin tatimor “*e-filing*” dhe/apo nëpërmjet shërbimit postar rekomande.

3. Aktet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik apo të postës rekomande. Për njoftimet elektronike, datë e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik dhe për dokumentet e dërguara me postë rekomande, datë e njoftimit është data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit për marrjen e akteve tatimore, sipas këtij ligji, në llogaritjen e afateve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, nuk përfshihet dita në të cilën del akti.

4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë të dhëna të sakta të lidhura me adresën dhe postën elektronike, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve.”.

Neni 2

Pas pikës 1, të nenit 40, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Veprimtaria ekonomiko-tregtare, në kuptim të këtij neni, përfshin edhe veprimtarinë e ushtruar nëpërmjet internetit. Personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar dhe entitetet, që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare sipas kësaj pike, duhet të publikojnë në faqen e internetit, nëpërmjet së cilës kryejnë këtë veprimtari, të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e NIPT-it;
- b) emrin e subjektit tregtar;
- c) adresën e selisë;
- ç) numrin e telefonit.

Kur administrata tatimore identifikon persona që ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare nëpërmjet internetit dhe nuk kanë publikuar në faqen e tyre elektronike këto të dhëna, u dërgon një njoftim zyrtar për publikimin e tyre.

Nëse brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit zyrtar nuk merren masa për publikimin e të dhënave, administrata tatimore i kërkon Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare bllokimin e përkohshëm të faqes së internetit, përmes së cilës ushtrohet aktiviteti.”.

Neni 3

Në fjalinë e dytë, të pikës 1, të nenit 41 pas togfjalëshit “sipas pikës 2, të nenit 121 të këtij ligji.” shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“... si dhe masat e tjera administrative, që parashikon ky ligj për të gjitha shkeljet e konstatuara nga administrata tatimore. Për mallrat e konstatuara pa faturë bëhet rivlerësimi i TVSH-së dhe i detyrimeve përkatëse tatimore bazuar në vlerën e tregut.

Në rast të mospërmbushjes së detyrimit për regjistrim, detyrimet tatimore dhe penalitetet, që lindin sipas kësaj pike, zbatohen nga administrata tatimore ndaj tatimpaguesit individ.”.

Neni 4

Pika 7, e nenit 44 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 59 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesit, personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar apo entitetet nuk mund të kryejnë ndërmjet tyre transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë kur vlera e transaksionit është më e madhe se 100 000 lekë.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Personat fizikë, individë tregtarë e të vetëpunësuar apo entitetet nuk mund të kryejnë transaksione shitjeje ose blerjeje me para në dorë me individë kur vlera e transaksionit është më e madhe se 500 000 lekë.”.

Neni 6

Pas nenit 59/2, shtohet neni 59/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 59/3

Pajisja me terminal “POS/POI”

1. Tatimpaguesit që kryejnë shitje me para në dorë duhet të jenë të pajisur me terminal “POS/POI” në çdo pikë shitjeje, sipas kalendarit të mëposhtëm:

a) Brenda datës 30 maj 2026 të gjithë tatimpaguesit, të cilët:

i. ushtrojnë aktivitet ekonomik si struktura akomoduese, sipas përcaktimeve në ligjin për turizmin, dhe, konkretisht: “Bujtinë”; “Bllok apartamentesh”; “Motel”; “Fjetje dhe mëngjes”; “Hotel”; “Hotel i shpërndarë”; “Resort” dhe “Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore”;

ii. ofrojnë shërbime në sektorin e transportit; si dhe

iii. institucionet publike dhe shoqëritë publike me kapital shtetëror;

b) Brenda datës 31 dhjetor 2026 të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike.

2. Përfshihen nga detyrimi i pajisjes me terminal “POS/POI”:

a) tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat ku nuk ka mbulim me internet;

b) tatimpaguesit që përfshihen nga detyrimi për të lëshuar faturë, sipas ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit;

c) tatimpaguesit, të cilët përmbushin njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

i. nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;

ii. kanë përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi;

iii. nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

iv. kanë statusin/kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm”.

3. Terminali “POS/POI” është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare apo të instrumenteve të tjera të pagesave elektronike në pikën e shitjes ose të ndërveprimit. Informacioni për pagesën merret nëpërmjet faturave letër nga terminalet mekanike ose elektronike.”.

Neni 7

Pika 1, e nenit 65, ndryshohet si më poshtë:

“1. Tatimpaguesi e dorëzon deklaratën tatimore në mënyrë elektronike nga llogaria e tij në sistemin informatik të administratës tatimore.”.

Neni 8

Në nenin 67 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2 togfjalëshi “brenda 36 muajve” zëvendësohet me togfjalëshin “brenda 24 muajve”.

2. Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Deklaruesi i deklaratës vjetore të të ardhurave personale mund ta korrigjojë deklaratën e dorëzuar brenda 6 muajve nga data e dorëzimit, por jo më shumë se dy herë.”.

Neni 9

Në nenin 69 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike, kur njoftimi i vlerësimit është nënshkruar elektronikisht; ose

b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë në rastet kur njoftimi i vlerësimit nuk është i nënshkruar elektronikisht.”.

2. Shkronja “a”, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

“a) emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik ose emrin e entitetit, adresën e selisë dhe adresën elektronike;”.

3. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 4 shtohen fjalët “ose në format elektronik.”.

Neni 10

Në shkronjën “e”, të pikës 1, të nenit 71 togfjalëshi “150 000 lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “100 000 lekë”.

Neni 11

Pas pikës 5, të nenit 71/1, shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rast se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e TVSH-së brenda afatit të përcaktuar në ligj, sistemi elektronik i administratës tatimore, brenda 24 orëve nga përfundimi i këtij afati, plotëson dhe dorëzon automatikisht deklaratën e TVSH-së mbi bazën e të dhënave të librit të shitjes e të librit të blerjes. Përgjegjësia për çdo penalitet për mosdorëzimin e saj në afat i ngarkohet tatimpaguesit, i cili ka të drejtën ta kontrollojë, ta ndryshojë apo ta korrigjojë deklaratën sipas procedurës dhe afateve të këtij ligji.”.

Neni 12

Pas pikës 1/2, të nenit 75/1, shtohet pika 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/3. Kërkesat për rimbursim të tatimpaguesit, për të cilin ka të regjistruar një çështje hetimore në proces, për konsumimin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me TVSH-në apo fshehje

të të ardhurave, parashikuar nga neni 144/a ose nga neni 180 i Kodit Penal, pezullohen deri në përfundim të veprimeve hetimore.”.

Neni 13

Pas pikës 4, të nenit 76, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Përgjashtimisht nga parashikimi në pikën 4 të këtij neni, kamatëvonesat e parashikuara nga ky ligj nuk zbatohen për njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur mosdeklarimi brenda afatit ka ndodhur si pasojë:

- a) e zbatimit të një akti ligjor apo nënligjor me efekte prapavepruese; ose
- b) e zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë.”.

Neni 14

Pika 4, e nenit 96, ndryshohet si më poshtë:

“4. Procedurat që do të zbatohen për shitjen e pasurisë së konfiskuar, në zbatim të aktit administrativ të konfiskimit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 15

Pas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 105, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) kryerjen e verifikimit dhe vlerësimit tatimor në përputhje me përcaktimet e kreut VIII të këtij ligji, në të gjitha rastet e konstatuara të konsumimit të veprës penale të fshehjes së të ardhurave kur vlera e tatimit, taksës apo kontributit të fshehur nuk është llogaritur paraprakisht, sipas kreut X të këtij ligji. Vlerësimi tatimor dhe nxjerrja e njoftimit të vlerësimit në këto raste bëhet vetëm pas autorizimit nga drejtori i përgjithshëm i Tatimeve.”.

Neni 16

Në nenin 115/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikat 2 dhe 3, togfjalëshi “të nenit 36, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” zëvendësohet me togfjalëshin “të nenit 32, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”.

2. Në pikën 3 togfjalëshi “në nenin 36/5 të ligjit” zëvendësohet me togfjalëshin “në nenin 37 të ligjit”.

Neni 17

Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 116 ndryshohet si më poshtë:

“c) pikën 4, të nenit 123 të këtij ligji;”.

Neni 18

Pas pikës 2, të nenit 124/1, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Prodhuesi ose mirëmbajtësi i *software*-it, programi i të cilit përdoret nga subjekti që lëshon fatura, që, për rastet e konfiskimit të pajisjeve fiskale, nuk bashkëpunon me administratën tatimore, me kërkesë të saj për hapjen ose verifikimin e pajisjeve, ku është instaluar ky program, dënohet me gjobë 1 000 000 (një milion) lekë për këtë shkelje.

4. Në rast se prodhuesi ose mirëmbajtësi i *software*-it, i cili është gjobitur sipas pikës 3 të këtij neni, refuzon për herë të dytë, pa shkaqe të arsyeshme, bashkëpunimin me administratën tatimore, komisioni i përhershëm për monitorimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, harton një

relacion sqarues dhe u propozon titullarëve të institucioneve, që kanë miratuar certifikimin, marrjen e masës së shfuqizimit të certifikatës. Titullarët përkatës vendosin nëse certifikata do të shfuqizohet ose jo.”.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 16, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.